



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports
Kabineti i Ministrit
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr. 200/2023
Datë: 24.11.2023

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 08/L -117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019) bazuar në Rregulloren (QRK) NR.14/2023 Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, duke u mbështetur në nenin 4 të Ligjit Nr.02/L-088 për Trashëgiminë Kulturore, Rregulloren Nr. 11/2022 për Inventarizimin dhe procesin e përzgjedhjes së trashëgimisë kulturore për mbrojtje, si dhe duke marrë për bazë propozimin e Kryetares së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore në lidhje me propozimet e shqyrtuara dhe të rekomanduara për përfshirje të aseteve të trashëgimisë kulturore në Listën për Mbrojtje të Përhershme me numër të protokollit 3878/2023 të datës 01.08.2023 si dhe listën me numër të protokollit 6197/2023 të datës 21.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Lista e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të përhershme, sipas propozimeve të shqyrtuara nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore.
2. Lista e miratuar si në pikën një (1) të këtij Vendimi, përfshin 26 (njëzet e gjashtë) asete të trashëgimisë kulturore si në vijim:
 - 2.1.Shtëpia e Zekirija Abdullahut, Gjilan;
 - 2.2.Kisha e Shën Anës, Dunav, Gjilan;
 - 2.3.Kisha e Shndërrimit, Pasjan, Partesh;
 - 2.4.Kompleksi i Ndërtesave: Xhamia dhe Kisha Ortodokse, Ferizaj;
 - 2.5.Objekti i ish Depos Ushtarake Turke, Gjilan;
 - 2.6.Shtëpia e Haxhi Ahmetit, Remnik, Viti;
 - 2.7.Teqja e Sheh Zenel Abedinit, Topanicë, Kamenicë;
 - 2.8.Xhamia e Koxha Sinan Pashës, Kaçanik;
 - 2.9.Kompleksi Monumental i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Prizren;

- 2.10. Kompleksi i Kishës Katolike Zonja Ndhmëtare, Prizren;
- 2.11. Kroi i Binbashit, Prizren;
- 2.12. Shtëpia e Musa Shehzades, Prizren;
- 2.13. Objekti i Kajmekamllëkut, Gjilan;
- 2.14. Shtëpia Muze e Ukshin Hotit, Krushë e Madhe, Rahovec;
- 2.15. Kulla e Rexhë Gashit, Abri e Poshtme, Skënderaj;
- 2.16. Xhamia e Trepçës, Mazhiq, Mitrovicë;
- 2.17. Qendra Historike e Prizrenit, Prizren;
- 2.18. Ambulanta e Vjetër - Shtëpia e Xhafer Devës, Mitrovicë;
- 2.19. Hamami i Qytetit, Mitrovicë;
- 2.20. Kulla e Astrit Tahsum – Kryeziut, Gjakovë;
- 2.21. Kulla e Hysni Koshit, Gjakovë;
- 2.22. Kisha Katolike Shën Antoni, Gjakovë;
- 2.23. Shtëpia e Mazllum Zherkës, Gjakovë;
- 2.24. Kulla e Ali Gecit, Llukë e Ulët, Deçan;
- 2.25. Bajrakli Xhamia, Pejë;
- 2.26. Bazilika Shën Pjetri, Stantërg, Mitrovicë.

3. Këtij Vendimi i bashkëngjitet edhe Listat e konsiderohet pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

4. Ky vendim hynë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministrisë;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Ministritë se Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;*
- *Komunave përkatëse;*
- *Inspektoratit për Trashëgimi Kulturorë;*
- *Departamentit për Trashëgimi Kulturorë;*
- *Institucioneve të Trashëgimisë Kulturorë;*
- *QRTK - ve përkatëse;*
- *Agjencionit Kadastral të Kosovës*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Arkivit të MKRS-së.*


Hajrulla Ceku
Ministër